

NOTE INFORMATIVE

Tiranë, më 15.02.2024

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Shkarkim nga detyra” ndaj gjyqtares K.A.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor me iniciativë, pas ankesës së një qytetareje, ndaj magjistrates K. A., me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit. (KPK me datë 10.09.2021 ka vendosur shkarkimin e magjistrates, vendim që është ankimuar në KPA. Meqenëse ende nuk ka një vendim përfundimtar dhe të formës të prerë nga KPA, kjo magjistrate vazhdon të ruajë statusin e magistratit për efekt të çdo procedimi disiplinor.)

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor ndaj gjyqtares K.A., rezulton se:

- Mosveprimi në kohë dhe vonesa e pajustificuar, tej çdo afati të arsyeshëm dhe objektiv (5 muaj e 22 ditë) në arsyetimin e vendimit nga ana e magjistrates K.A., ka sjellë si pasojë zvarritjen e pajustificuar të procesit gjyqësor, pjesë përbërëse e të cilit është dhe vendimi i arsyetuar, si dhe vonesa në komunikimin e vendimit palëve ndërgjyqëse, paraqitjen e ankimit nga ana e tyre, si dhe shqyrtimin e këtij ankimi nga gjykata më e lartë, pjesë përbërëse e vetë procesit gjyqësor.
- Nga të dhënat e marra gjatë hetimit për periudhën e mësipërme të vonesës, rezulton se nuk është rast i izoluar, pasi magistratja ka vonesa të theksuara në dorëzimin e vendimeve të tjera arsyetura në një afat nga 3 deri në 6 muaj vonesë. Nga hetimi disiplinor i kryer rezulton se vendimet gjyqësore me afatet më të konsiderueshme të vonesave në arsyetimin e tyre lidhen me lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtës, vonesa që rezultojnë nga mbi 5 deri mbi 8 muaj.
- Vonesat e evidentuara në këtë rast, tej çdo “afati të arsyeshëm”, cenojnë jo vetëm të drejtat e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, por edhe besimin, që kjo kategori vulnerabël shoqërore duhet të ketë tek institucionet e drejtësisë (në këtë rast gjykata), nëpërmjet respektimit të afateve procedurale në rradhë të parë dhe marrjes së masave për të garantuar respektimin e të drejtave dhe integritetit të tyre.
- Pavarësisht eksperiencës së gjatë të saj në detyrë, gjyqtarja ka dëmtuar dukshëm imazhin e drejtësisë dhe besimin e publikut në të, pasi vonesat e evidentuara kanë qenë të përsëritura e të vazhdueshme dhe nga veprimet e gjyqtares, duket qartë një neglizhencë në ushtrimin e detyrës dhe në realizimin e funksionit bazë atë të dhënies së një vendimi gjyqësor.

Për sa më sipër, konkludohet se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates K.A., përbëjnë “Shkelje shumë të rëndë disiplinore”, kërkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 111 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.